



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR PROVUES

Viti shkollor 2018/2019

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено јавно објављивати без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.

1. Dëshirat e fëmijëve

Para se të vinte, plaku i Vitit të Ri, shkoi në shitore. U maskua si shitës e nisi të flasë me fëmijët për dhuratat e Vitit të Ri. U jepte karamelle dhe u shkruante emrat në fletore. Donte të dinte për lodrat që ata i pëlqenin.

Kur erdhi Plaku i Vitit të Ri, fëmijët u habitën. Ai u kishte sjellë dhuratat që ata dëshironin. Të habitur e të kënaqur, fëmijët morën dhuratat dhe e falënderuan.

- Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego: Si i kuptoi Plaku i Vitit Të Ri dëshirat e fëmijëve?

- a) Foli me telefon me fëmijët;
- b) I dërgoi letra;
- c) U shkroi emrat në fletore.

2. Gomari në festë

- Gomari ishte i mërzhitur sepse kafshët e shanin, duke thënë, se je shumë i shëmtuar.

Një ditë ai përgatiti një maskë të bukur, e veshi dhe u nis në festën e kafshëve.

Kur mbërriti, të tëra kafshët e përshëndetën dhe askush nuk e njohu. Gomari u ndie i lumtur dhe nga gëzimi e lëshoi një pëllitje të fortë.

Kafshët u shtangën e mbetën gojëhapur. Ato e kuptuan se pas maskës fshihej gomari. Filluan të qeshin e të tallen me të. Gomari sa nuk plasi nga inati. U ngrit nga vendi dhe iku në shtëpi i vetmuar.

- Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego nëse gomari është:

- a) I bindur
- b) I shëmtuar
- c) I dobishëm

3. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe trego:

I dashur Ilir, mbaje veten!

Je gati? Po ta shkruaj këtë mesazh me kompjuterin tim të ri! Është e vërtetë! Ende nuk më besohet! Mamaja erdhi dje në shtëpi dhe më kërkoi ta ndihmoja të ngrinte bagazhet. Kundërshtova pak, por natyrisht shkova dhe e ndihmova. Kur ç'të shoh, një kompjuter fringo i ri brenda në një kuti. Është fantastike! Përse nuk vjen ta shohësh? Do të ishte shumë bukur të takoheshim. Si thua?

*Të përqafoj fort,
Emi*

Në këtë tekst gjeje cili është dërguesi dhe cili është marrësi?

- a) _____
- b) _____

4. Numrat e dhënë shkruaj me fjalë:

3, 98, 2836, 1230.

5. Fjalët e dhëna, nëse janë shkruar drejt nënvizojë shkronjën S (saktë), nëse nuk janë shkruar drejt nënvizojë shkronjën P (pasaktë)

1. Shnderoj	S	P
2. Çfaq	S	P
3. Kurbet	S	P
4. Dusheme	S	P
5. Fishek	S	P
6. Byrek	S	P

6. Në shembujt e më poshtëm, rretho shkronjën ku data është shkruar drejt:

- a) Festivali fillon nga data 22-III-2017.
- b) Provimi do të mbahet më 04.11. 2017.
- c) Beni ka datëlindjen më 03.02.2004.
- ç) Ndashja zhvillohet më 5.7.2018.
- d) Mbledhja është mbajtur më 26 mars 2011.
- dh) Ne do të shkojmë më datën 25. II. 2018.
- e) Shkollat u hapën më 01. shtator. 2017.

7. Në vijat e zbrazëta shkruaj klasat e fjalëve që janë përdorur në fjalinë e dhënë:

Njeriu i fortë gjithmonë ia del mbanë.

Njeriu _____
 i fortë _____
 gjithmonë _____
 ia _____
 del _____
 mbanë _____

- 8.** Lidhëzat në kllapa klasifikoji sipas mënyrës së formimit:(derisa, ose, ngado, po, edhe pse, jo vetëm që, ku, o, se sa, në mënyrë që, kurse, sa herë që).

Shkruajji ato në vizat përkatëse.

Të thjeshta

Të përngjitura

Shprehje lidhëzore

- 9.** Për ta realizuar komunikimin jogjuhësor duhet të përdorësh:

Në vijën e zbrazët shkruaj mjetet:

- 10.** Në fjalinë e dhënë:

Vjershën, nuk po e reciton bukur.

Në cilën mënyrë dhe kohë është kjo fjali:

a) *Mënyra:* _____

b) *Koha:* _____

- 11.** Në fjalinë e poshtëshënuar, si quhen këto tri (3) pika që janë përdorur në këtë fjali?

S'më duket dhe kaq... Sot sa t'u bien në qafë arrëzat....

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) *Pikat e heshtjes;*

b) *Përfundim i fjalisë;*

c) *Fjalialia e pakuptimtë.*

12. Në vend të pikave vini ndajfoljet e duhura:

Kur fëmijët zbresin _____, gjenden buzë liqenit, ndërsa kur marrin rrugën _____ arrijnë deri tek një dru i madh. Një ditë fëmijët dolën _____ që të luanin.

13. Në vijat e poshtëshënuara shkruaj zanoret:

a) E ngritjes së lartë _____, _____, _____

b) E ngritjes së mesme _____, _____, _____

c) E ngritjes së ulët _____

14. Në vijat e zbrazëta shkruaj klasën e fjalëve duke u përqendruar në veçoritë e tyre:

VEÇORITË

KLASA E FJALËS

1. mohuese

2. sasië

3. lidhor

4. koha e kryer

5. trajta e shquar

6. themelor, i thjeshtë

7. i nyjshëm

15. Lexo vargjet e mëposhtme.

Ka filluar të plaket nëna.

Fytyra e saj po mbulohet me rrudha.

Po mbulohet me një pleqëri të bukur.

Çështë kështu moj rrjetë që hedh koha mbi nënën time?

Dhe duart që më mbanin mua , tani janë rënduar.

Po s'ka gjë.Nga shpirti i saj

Zgjaten duart tjera që më mbajnë pezull.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) Ditar;

b) Ninullë;

c) Portret.

16. Lexo tekstin me vëmendje dhe rretho shkronjën përpara:

*Ka nisë provën e provë po ban:
I ka mbledhë nantë gjarpna t'shullanit,
Në gjoks gjarpnat trimi i ka vue,
Sa fort gjarpnat e kanë qokatë,
sa i gjallë kish qenq për t'gjallë s'u ndie!
I ka ndezë dy zjarre të mëdhenj
E ndërmjet Osmanin po na shtjen,
Para e mbrapa lëkura m'i pëlçet,
Gjallë kish' qenë , për t'gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.
M'i ka marrë njëzet maja gozhdash,
për nën thoj thellë ia ka shtie,
derisa gjaku trimit m'i ka dalë
Gjallë kish qenë, për të gjallë s'u ndie!
Aspak besë krali s'i ka zanë.*

Cilit lloj të gjinisë letrare i takojnë vargjet e dhëna?

- a) Epikës;
- b) lirikës;
- c) dramatikës.

17. Lexo tekstin e poshtëshënuar.

Mori e mira po ban vek
ban qylyma e ban dyshek.
T'lumshinduert, sa rrept po qet!
Njana kamë po m'hjek zemet,
njana makë e njana dorë
ka po baj pëlhurë të hollë.

1. Teksti i përket letërsisë: _____;
2. Kjo i përket ciklit të këngëve të _____.

18. Më poshtë janë paraqitur tre stile të shkrimit të gjuhës letrare:

Stili artistik;

Stili shkencor – teknik

Stili administrativo – juridik

a. Shkresa, autorizime, vërtetime, kërkesa, akte ligjore, rregullore;

b. Proza, poezia, drama;

c. Artikuj, studime, tekste mësimore, kritika, diskutime, referate.

Shkruaj cilit stil i takojnë shkrimet e dhëna.

a. I përkasin stilit

b. I përkasin stilit

c. I përkasin stilit

19. Ç` është romani?

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) *romani është ese;*

b) *lloji më i gjatë dhe më i rëndësishëm i prozës;*

c) *romani është një fragment.*

20. Vaji i Bylbylit

Po shkrihet bora

Dimni po vjen

Bylbyl i varfun

Pse po gjëmon

Lexo me kujdes vargjet e poezisë së lartshënuar dhe trego se çfarë paraqet poeti:

a) Dashurinë ndaj bilbilit;

b) Vetminë personale të poetit;

c) Dashurinë për atdheun

Rezultati në testin nga gjuha shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!

Rezultati i përgjithshëm në test
(prej 0 deri 20)

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____

Kontrolluesi:

- _____

Rezultati në nivel të detyrës

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pikët	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✘ në vendin përkatës.

Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	